

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR “SRM Construction” SH.P.K**

Sot, më datë 21/04/2023/ në cilësinë e ortakëve themelues, unë **Sejdi Muçobega** i biri i **Mustafa** dhe e **Pushime**, datëlindja 23 tetor 1991, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, lindur në Memaliaj dhe banues në Fier, shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akt Themelimi të shoqërisë “**SRM Construction” Sh.p.k**

Me nënshkrimin e këtij akti themelimi të shoqërisë tregëtare, unë nënshkruesi dhe themeluesi i saj marrë përsipër të realizojë e të respektojë, të drejtat dhe detyrimet me precezimet e mëposhtme:

NENI 1

Në përputhje me kërkesat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” ligjit 9723 datë 08.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” është formuar shoqëria tregëtare “**SRM Construction” SH.P.K**

NENI 2

Shoqëria e ka selinë e saj në Fier, Lagja Apollonia Ndërtesa nr 1, rruga Jakov Mile, Hyrja 15, Kodi postar 9302, Fier

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë parashikohet pa afat ,por ky afat mund të ndërpritet apo të zgjatet më tej ,gjithmonë në funksion të kompetencave të ortakëve themelues të saj.

NENI 4

Si rregull aktiviteti i shoqërisë mund të zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, por ai mund të ushtrohet dhe jashtë këtij territori, me hapjen e filialeve apo nëpërmjet veprimtarive të tjera të karakterit tregëtar.

NENI 5

Themeluesi i vetëm i Shoqërisë “**SRM Construction” SH.P.K** me akt themelimi merr përsipër që të respektojë të gjitha detyrimet që parashikon legjislacioni tregëtar e civil shqiptar për shoqëritë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, si dhe ti përmbahet kriterit të respektimit të politikës tregëtare që zhvillohet sot në Republikën e Shqipërisë.

NENI 6


Digitally signed by Sejdi
Muçobega
Date: 2023.04.25
19:46:31 +02'00'

Kapitali themeltar i Shoqërisë “*SRM Construction*” SH.P.K në momentin fillestar të krijimit është 100,000 (njëqindmije) lekë, i cili është regjistruar në llogarinë e shoqërisë pranë bankës shqiptare.

Me legalizimin e Shoqërisë në organet kompetente të shtetit Shqiptar dhe me fillimin e ushtrimit të aktivitetit të saj, kapitali Themeltar i kësaj shoqërie mund të zmadhohet .

NENI 7

Shoqëria “*SRM Construction*” SH.P.K ashtu sikurse është parashikuar në Aktin Themelues të Shoqërisë, aktivitet të saj kryesor do të ketë :

Punime murature, karpentier, armatur, veshje pllakash, hekurkthyes etj. Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, ndertesa shumëkateshe, rikonstruksione, punime mirëmbajtje, shërbime fasade. Ndërtim vepra kullimi, ujitje, ujësjellsa dhe kanalizimesh, punime hidraulike, elektrike etj. Ndertimi ambiente dhe sistemin gjelberimi, parqe e lulishte.

NENI 8

Ortakët e shoqërisë kanë vendosur që si administrator i Shoqërisë “*SRM Construction*” Sh.p.k të jetë **Z. Sejdi Muçobega**

Ai përgjigjet mbi bazën e kompetencave të tij të percaktuara në aktin e themelimit të shoqërisë. Gjithashtu ai merr përsipër se do konfirmojë emrat e ortakëve që mund të shtohen ,pjesët e kapitalit themeltar si dhe shumën e derdhur nga secili prej tyre.

Gjithashtu ai përgjigjet për administrimin e vlerave pasurore të Shoqërisë , të cdo natyre qofshin ,të shlyejë detyrimet që ka Shoqëria me të tretët brenda vlerës së kapitalit ,të bëjë mbi bazën e kontributeve të dhëna shpërndarjen e fitimit.

Si organ ekzekutiv i Shoqërisë ,të drejtat dhe detyrat e administratorit ,rregullohen me aktet themeluese të Shoqërisë, Statutin e Shoqërisë si dhe aktet e tjera normative të nxjerra nga Asambleja e Ortakëve apo dhe me marrveshje të vecanta.

NENI 9

Mandati i Administratorit, për administrimin në këtë shoqëri, është për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet.

Administratori i shoqërisë emërohet **Z. Sejdi Muçobega**

Administratori apo ai që i delegohet ky pushtet, ka të gjitha kompetencat të cilat ai deklarohe se i njeh dhe i pranon, për të kryer të gjitha detyrimet që i lindin në bazë të statutit të Shoqërisë, sikurse parashikohet në legjislacionin e Shtetit Shqiptar dhe në mënyrë të vecante në “Tre Ligjet për Shoqëritë Tregtare “

NENI 10

Kjo kontratë Themelimi hartohet në Fier në 5 ekzemplare origjinale, duke patur secila nga kopjet vlerë të barabartë ligjore e kuptimore.

Mucobeg

Digitally signed by Sejdi
Mucobeg
Date: 2023.04.25
19:46:31 +0200

NENI 12

Ortaku themelues **Sejdi Muçobega** deklaron se i njeh të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky Akt – themelues i Shoqerise “*SRM Construction*” *Sh.p.k* dhe me vullnet të lirë e firmos atë .

PER SHOQERINE “ *SRM Construction*” *Sh.p.k*

ORTAKU
Sejdi Muçobega



Sejdi
Mucobeg

Digitally signed by Sejdi
Mucobega
Date: 2023.04.25
19:46:31 +02'00'